

**Rregulat e veçanta për vlerësimin e Eksponeve të Kartolinave në ekspozitat e FEPA-s
Athinë 15 Nëntor 2015**

1. Ekspozitat konkurruese
Klasa e kartolinave është pranuar si klasë konkurruese për Ekspozitat Kombëtare, Rajonale dhe të FEPA-s, aprovuar nga Federatat përkatëse.

2. Përcaktimi i një kartoline
Një kartolinë duhet të ketë një ilustrim. Dhe më tej....

Kartolinat e përdorura (të qarkulluara nëpërmjet shërbimit postar apo çdo mënyrë tjetër e trajtuar në postë) duhet të tregojnë se ato kanë kaluar nëpërmjet Shërbimit Postar.

Kartolinat e papërdorura (të pa-trajtuar postërisht) duhet të kenë tekst të printuar ose të printuara vijat e adresës, p.sh. një zonë postimi, që të tregojë se kartolina do të përdoret në Postë pa zarf.

Lejohen vetëm kartolinat origjinale të kohës; rishtypjet e prodhuara me vonë do të ekspozohen vetëm në raste të veçanta.

Kartolinat mund të prodhohen me materiale të llojeve të ndryshme (vizatim me dore ose të pikturuara, qëndisura etj.)

Ekspoziti duhet të ekspozohet në kornizat e ekspozitave të formatit standard ndërkombëtar me 16 faqe A4 për kornizë ose ekuivalentin e tyre.

3. Parimet e ndërtimit të ekspozitës

3.1 Idea, Plani dhe trajtimi

Një ekspozitë e kartolinave trajtohet nga pikëpamja gjeografike (topografike), tematike, ose sipas një aspekti të veçantë (një artisti, printimi, materiali), krejtësisht në varësi të zgjedhjes personale të ekspozuesit.

Titulli dhe Plani duhet të paraqiten në faqen hyrëse dhe duhen shkruar në një nga gjuhët zyrtare të FIP-it.

Plani duhet të tregojë qëllimin dhe strukturën e ekspozitës. Titulli po ashtu si dhe pjesa kryesore dhe nënkapitujt e ekspozitës duhet të tregojnë strukturën dhe ndërtimin logjik, të demonstrojnë kreativitetin personal, njohuritë dhe punën kërkimore.

Titulli duhet të pasqyrojë përmbajtjen e ekspozitës në mënyrën më të mirë të mundshme. Trajtimi i ekspozitës duhet të jetë në përputhje me titullin dhe planin. Çdo kartolinë duhet të ketë lidhje me çështjen e zgjedhur.

Varieteti (diversiteti) i materialit është i një rëndësie të veçantë.

3.2 Njohuria dhe Kërkimi

Kërkimi është kusht paraprak për Njohurinë mbi çështjen (temën) dhe Kartolinën dhe kjo demonstron me një tekst të shkurtër në lidhje me çdo kartolinë.

3.3 Gjendja dhe rrallësia

Objektet e zgjedhura duhet të tregojnë cilësinë më të mirë të mundëshme në dispozicion të subjektit të zgjedhur. Rrallësia lidhet direkt me vështirësinë e gjetjes së kartolinave të tilla dhe vështirësinë e blerjes.

3.4 Paraqitja

Madhësitë e fletëve të rekomanduara janë:

- 1) 21 cm x 29.7 cm (madhësia A4) ose 23 cm x 29 cm – 4 fletë në një rresht
- 2) 42 cm x 29.7 cm (A3) ose 46 cm x 29 cm – 2 fletë në një rresht
- 3) 31 cm x 29 cm – 3 flete në një rresht

4. Gjykimi i eksponatit

Një eksponat i kartolinave duhet të gjykohet nga një juri e përbërë nga ekspertë të këtij materiali, me dakordësinë e Federatave përkatëse.

5. Vlerësimi

Eksponatet do të vlerësohen sipas kriterëve të mëposhtëme.

Idea, Plani (10) dhe trajtimi (20)	30
Njohuria dhe Kërkimi	35
Gjendja (10) dhe rrallësia (20)	30
Paraqitja	5
Gjithsej	100

6. Çmimet

Sipas këtyre rregullave çmimet mund të përcaktohen nga Komiteti Organizues në bashkëpunim me Federatat përkatëse.

Eksponatet e kartolinave mund të vlerësohen me çmime të veçanta dhe urimet e jurisë.

7. Klauzolë përfundimtare

7.1 Në rast të ndonjë kundërshtie në tekst që lind nga përkthimi, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

7.2 Këto rregulla të veçanta për vlerësimin e eksponateve të Kartolinave në ekspozitat e FEPA-s u aprovuan nga Kongresi i FEPA-s në Athinë, më 15 nëntor 2015. Ato janë subjekt i rishqyrtimit në Kongresin e FEPA-s 2018. Këto rregulla do të zbatohen në të gjitha ato ekspozita që gëzojnë Patronazhin, Mbështetjen apo Njohje nga FEPA, gjatë ose pas Kongresit të FEPA-s 2015.

Shënimi im: Në Kongresin e FEPA-s 2018 në Pragë u konkludua se eksperiencia e fituar nuk ishte e mjaftueshme për rishikimin e këtyre rregullave dhe u vendos shtyrja për dy vjet edhe për të shfrytëzuar eksperiencën e Fip-it gjatë kësaj kohe .

Përkthyer nga Edmond Budo

Tiranë, më 23.02.2019

Udhëzime për Gjikimin e Eksponeve të Kartolinave

1. Hyrje

- 1.1 Qëllimi i këtyre udhëzimeve është që të mbështesë Jurinë si dhe ekspozuesin dhe të sigurojë këshilla praktike se si të përdoren rregullat e veçanta për ekspozitat e Kartolinave.
- 1.2 Rregullat e veçanta për ekspozitat e kartolinave përfshijnë parimet e përgjithshme se çfarë mund të përmbajë një ekspozitë e Kartolinave dhe se si duhet trajtuar dhe paraqitur.
- 1.3 Këto udhëzime nuk janë gjithëpërfshirëse. Çdo ekspozitë gjyket nga meritat (vlerat) e tij.
- 1.4 Ekspozuesi mund të shfrytëzojë mundësinë e paraqitjes së ekspozitës me hollësi në mënyrë të përmbledhur tek Komiteti Organizues përpara zhvillimit të ekspozitës. Kjo përmbledhje nuk zëvendëson faqen hyrëse apo planin por e plotëson atë duke paraqitur më me hollësi trajtimin, zgjedhjen, kërkimin, njohurinë dhe paraqitjen e ekspozitës. Rekomandohet që një përmbledhje të përmbajë maksimumi dy faqe fletë format A4.

2 Përcatimet e një Ekspozite kartolinash

2.1 Ekspozita

Një ekspozitë kartolinash mund të ketë një trajtim gjeografik (Topografik), duke përfshirë p.sh. ilustrime nga një vend ose zonë. Ai mund të trajtohet edhe tematikisht. Një ngjarje mund të tregohet në formë të një reportazhi, ose ekspozita mund të ketë si çështje (synim) fotografimin, artistin, shtypshkronjën, procesin e printimit ose materialin. Mendimi origjinal dhe kreativiteti gjithashtu mund të çojë në një trajtim ndryshe të ekspozitës.

2.2 Kartolina

Madhësia, forma dhe materiali i kartolinave mund të jetë i ndryshëm. Kryesorja (theksi) është tek pamja dhe jo në përdorimin dhe në veçantitë filatelike (po të jenë të pranishme). Kartolina mund të jetë e papërdorur ose e përdorur (dërguar nëpërmjet një sistemi postar). Kartolina e papërdorur duhet të ketë të printuara vijat e adresës, kuadratin e pullës apo shenja të tjera të tilla që tregojnë se objekti kishte si qëllim që të dërgohej pa zarf.

3. Kriteret e gjyqimit

3.1 Idea, Plani dhe Trajtimi

Duhet të ketë një lidhje të qartë ndërmjet titullit, strukturës dhe trajtimit, duke përfshirë informacionin se si ekspozuesi ka zgjedhur të trajtojë çështjen, d.m.th. zgjedhja e kartolinave për të ilustruar çështjen dhe se si ekspozuesi e ka përdorur materialin. Hyrja duhet të të çojë tek linja që ke si qëllim të trajtosh që e mbart shikuesin nëpër ekspozitë. Origjinaliteti, imagjinata dhe idetë krijuese do të vlerësohen në mënyrë të veçantë.

Idea dhe plani do të vlerësohen në përputhje me korrespondencën ndërmjet titullit, planit dhe zhvillimit të historisë (çështjes së zgjedhur) gjatë gjithë ekspozitës.

Trajtimi do të vlerësohet duke konsideruar zgjedhjen e objekteve (kartolinave) dhe se ku ato janë vendosur në linjën që po trajton po ashtu si dhe në pozicionimin e tekstit përkatës në lidhje me objektin e paraqitur. Varieteti (Diversiteti) i materialit është i rëndësishëm dhe do të shpërblehet.

Trajtimi dhe përshkrimi i hollësishëm i tipografisë, metodës së printimit dhe botuesit janë njëloj të rëndësishëm. Nëse një informacion i tillë nuk është i disponueshëm

(**nuk pasqyrohet ne kartolinë- shënimi im**) , kjo është një arsye se pse duhen dhënë shpiegime.

Materiali fotografik arkivor origjinal i përdorur si bazë për prova dhe kolaudim në prodhimin e kartolinave do të vlerësohen.

Foto kartolinat e prodhuar privatisht, të cilat janë dërguar me shërbim postar, nuk janë në vetvete të përshtatëshme për të gjithë eksponatin, ndonësë lejohen si pjesë e eksponatit.

3.2 Njohuria dhe Kërkimi

Kërkimi është parakusht për Njohurinë mbi çshtjen(temën) dhe kjo duhet dokumentuar nëpërmjet zgjedhjes dhe varietetit të materialit po ashtu si dhe me një tekst të shkurtër në lidhje me kartolinën. Teksti duhet të përmbajë informacion thelbësor mbi çështjen dhe mund të përmbajë informacion mbi fotografimin apo artistin. Informacioni mbi tipografinë, metodën së printimit dhe printërit/botuesit mund të demonstrohet në mënyrën e duhur. Kartolinat duhen zgjedhur në përputhje me temën dhe përshkrimi duhet të jetë i saktë.

Njohuria dhe kërkimi personal mund të demonstrohet nga prezenca e materialit, kur pak ose aspak kërkim nuk ka qënë ndërmarrë, p.sh në një zone të pazakontë të koleksionimit. Njohuria mbi çështjen mund të tregohet gjithashtu nga përdorimi i materialit që ka një veti specifike të zbuluar nga ekspozuesi.

3.3 Gjëndja dhe Rrallësia

Cilësia më e mirë e mundëshmë që është në dispozicion duhet ekspozuar. Qoshet që mungojnë apo të përkulura, gërvishtjet apo konsumimet , etj. influencojnë në gjëndjen, megjithatë garantohet një farë tolerance për objektet më të vjetra dhe të postuara. Në këtë rast futen dhe Kartolinat e vjetra me shkrim dore në pjesën e përparme, përpara se të futej pjesa e ndarë prapa, për derisa ky shkrim nuk është i një cilësie të keqe me pika boje, njollosje etj.

Rrallësia lidhet direkt me vështirësinë në gjetjen e kartolinave të tilla, vështirësinë në blerje. Sa e vështirë do të ishte të dublikohe eksponatin. Disa kartolina “ Foto reale” mund të jenë shumë pranë unicitetit sepse ato shpesh janë prodhuar në numër shumë të vogël. Bile dhe disa kartolina të printuara mund të jenë jashtëzakonisht të vështira për t'i gjetur.Kartolinat që trëgojnë hollësi me njerëzit, aktivitetet, transportin etj. janë më të rëndësishme se sa pamjet e përgjithshme.

Kartolinat e moshës së artë shpesh u printuan nga disa botues në një numër variacionesh. Variacionet e kohës mund të trajtohen si origjinale ndërsa rishtypjet moderne duhet të deklarohen si të tilla. Objektet e falsifikuara të cilat nuk shënohen qartësisht se janë të tilla do të shkakëtonin zhvlerësimin e eksponatit nga juria.

3.4 Paraqitja

Teksti duhet të jetë tërheqës dhe sistemuar me shije. Përshtypja e përgjithshme e eksponatit është e rëndësishme, siç është dhe varieteti në montim. Faqet e ngjyrosura rëndë duhet të mënjanojnë. Inkuadrimi i Kartolinës mund të rrisë përshtypjen vizuale. Ilustrimet (hartat, vizatimet, etj.) apo objektet të cilat kanë lidhje direkte me çështjen apo trajtimin e kartolinave, mund të përdoren në një numër të kufizuar, por jo aq sa kartolina të dalë në plan të dytë në eksponat.